

Shabani mësoi për ngjarjet e Likoshanit/Likošane [të shikohen regjistrimet], ai u tha familjarëve se do të shkonte të shihte çfarë po ndodhte atje. Nuk kishte thënë se në të cilin vend do të shkonte saktësisht. Familjarët nuk e kanë parë të gjallë kurrë më. Asllani kishte dëgjuar nga disa njerëz në qytet se pjesëtarët e forcave serbe e kishin arrestuar Shabanin në afërsi të fabrikës së *Ferronikelit* [**Glogoc/Glogovac**] dhe e kanë çuar në drejtim të panjohur. Më në fund, Asllani e ka gjetur trupin e pajetë të të atit në Prishtinë/Priština, në mesin e viktimave të Likoshanit/Likošane. Familjarët e kanë varrosur Shabanin në varrezat e Gllanasellës/Gladno Selo më 5.03.1998. Kurrë nuk kanë mësuar se ku ishte gjetur kufoma e Shabanit.

**Burimi:** deklarata A.K, FDH-35225.

### **Goran (Rajko) Radojičić**

(1.05.1968, serb nga Pançeva, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

### **Miroslav (Dragutin) Vujković**

(10.01.1971, serb nga Pançeva, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Gorani dhe Miroslavi kanë punuar në SPB-në e Pançevës nga data 1.05.1993. Që të dy u sistemuan në Kosovë në fillim të vitit 1998. U dislokuan me detyrë në Stacionin Policor në Glogoc/Glogovac. Në datën **28.02.1998**, rreth orës 11:30, ata e patrullonin rajonin e Likoshanit/Likošane. Gjatë patrullimit, kanë marrë thirrjen për tu ndihmuar kolegëve, mbi makinën e të cilëve kishin hapur zjarr pjesëtarët e UÇK-së, përderisa ata po kalonin nëpër Likoshan/Likošane. Në ndërkohë, shtabi policor në Prishtinë/Priština ka dërguar me helikopter përforcime të forta në rajonin e Likoshanit/Likošane, të përbëra prej një numri të madh pjesëtarësh të Forcave Speciale Antiterroriste [FSA]. Përderisa policët Radojičić dhe Vujković kalonin me veturën zyrtare *Lada Niva* nëpër *Mëhallën Gjeli* [**Likoshan/Likošane**], ata u sulmuan me armë zjarri. Që të dy gjeten vdekjen gjatë shkëmbimit të zjarrit. U varrosën në Varrezat e Reja në Pançevë më 3.03.1998.

**Burimet:** deklarata Z.R, FDH-15401; SMIP,

*Teroristički...*, III, 345, 905, 932; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 20, 57; OKMSSRJ, KMKKRF], *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 103; *Tata se nije vratio*, Ilustrovana politika, 1.03.1998. FDH-31799; *Sahranjena dvojica policajaca*, Naša Borba, 4.05.1998, FDH-31800.

### **Radojica (Dragutin) Ivanović**

(29.11.1969, serb nga Prishtina/Priština, tre fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

### **Milan (Bogoljub) Jovanović**

(11.07.1971, serb nga Lazarevci, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Radojica, bashkëshortja Ljiljana dhe fëmijët Milijani, Konstantini dhe Milutini jetonin në lagjen *Bregu i Diellit/Sunčani breg* në Prishtinë/Priština. Milani me origjinë ishte nga fshati Boljeviqi të komunës së Bratunacit [BdheH]. Në MPB-në e Serbisë ka punuar nga viti 1992. Që të dy kanë qenë pjesëtarë të Forcave Speciale Antiterroriste [FSA].

Radojica dhe Milani kanë rënë në **Qirez/Ćirez** më **28.02.1998**, pas orës 15:00. Përderisa i afroheshin shtëpisë së familjes Sejdiu, dikush ka shtënë ndaj tyre nga drejtimi i ahurit. Radojica u varros në varrezat e Prishtinës/Priština më 1.03.1998, ndërkaq Milani në Lazarevc më 2.03.1998.

**Burimet:** deklarata Z.R, FDH-15401; deklarata M.J, FDH-36484; SMIP, *Teroristički...*, III, 905, 932; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 28, 32; KMKKRF], *Personat...*, FDH-10832; Stijović, *Kosmet...*, 103; *Tata se nije vratio*, Ilustrovana politika, 1.03.1998, FDH-31799; *Sahranjena dvojica policajaca*, Naša Borba, 4.05.1998. FDH-31800.

### **Rexhep (Ajet) Rexhepi**

(10.09.1935, shqiptar nga Qirez/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, katër fëmijë, punëtor ndërtimor, pjesëtar i UÇK-së)

Rexhepi ka marr pjesë në demonstratat kundër regjimit serb në vitin 1981. Në përleshjet me policinë serbe, e cila u zhvilluan më **28.02.1998**, pas orës 12:00, pranë shtëpisë së Bajram Gjelit, në **Likoshan/Likošane**, Rexhepin e kanë plagosur rëndë. Bashkëlufëtaret, Xheme